



**VENDIM**

**Nr. 166 Datë 28.12.2015**

**MBI**

**KËRKESËN E KESH SH.A. PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË SHIT – BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE MIDIS SHOQËRISË KESH SH.A DHE SHOQËRISË “HEC LANABREGAS” SH.A**

Në mbështetje të nenit 16 dhe 22 gërma ë të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, Nenit 3, pika 1, gërma “rr” dhe 14 të Ligjit nr. 138/2013 “Për burimet e rinovueshme të energjisë”, pikës 4 të Modelit të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike miratuar me VKM nr. 338, datë 19.03.2008, të ndryshuar, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2015, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të ERE-s dhe kërkesën e KESH sh.a. për miratimin kontratës së shit-blerjes së energjisë elektrike midis shoqërisë KESH sh.a dhe shoqërisë “Hec Lanabregas” sh.a.,

**Konstatoi se:**

- Palët e kësaj kontrate KESH sh.a./FPSH dhe HEC Lanabregas sh.a., janë të licensuara për të ushtruar aktivitet në sektorin e energjisë elektrike nga ERE me vendimet respektive.
- Marrëdhënia ndërmjet KESH sh.a (FPSH) dhe Prodhuesve të Vegjël të Energjisë ( HEC Lanabregas sh.a. ) është një marrëdhënie e rregulluar nga ERE.
- Modeli i Tregut vendos ERE-n në cilësinë e autoritetit që ka të drejtën për të miratuar këtë kategori kontrate (Miratuar me Vendimin nr 80 datë 23.10.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE).
- Është në autoritetin e ERE-s përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve respektive ndërmjet pjesëmarrësve të tregut si dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet tyre ;
- Me miratimin e kontratës TIP, KESH sh.a. dhe prodhuesit e vegjël të energjisë elektrike, që operojnë në treg, gjenden përpara detyrimit të respektimit të kushteve të parashikuara në kontratë.

- HEC Lanabregas ka një kapacitet të instaluar më të vogël se 15 MW, është i lidhur në shpërndarje dhe në bazë të ligjit nr. 138/2013 “Për burimet e rinovueshme të energjisë”, ai kategorizohet si prodhues me përparësi, që prodhon energji elektrike nga burimet e rinovueshme.
- Energjia që prodhohet nga ky burim gjenerimi i rinovueshëm ( HEC Lanabregas), duhet të blihet nga furnizuesi publik me shumicë, në bazë të çmimeve të rregulluara

Për gjithë sa më sipër Bordi,

### **Vendosi :**

1. Marrëdhënia e shitblerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga HEC Lanabregas për KESH sh.a., për vitin 2015 e në vijim, rregullohet nga Kontrata tip e miratuar me Vendimi nr 80 datë 23.10.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE “Për miratimin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a./FPSH dhe prodhuesve të vegjël të energjisë elektrike, ndryshuar”, dhe i shtrin efektet juridike që nga 01.01.2015 e deri në përfundimin e afatit të kontratës TIP siç parashikohet në nenin 15 të saj.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Petrit AHMETI**